

**N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.**

Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.

e-mail: [contact@pallatirinise.com](mailto:contact@pallatirinise.com)

www. pallatirinise.com

Dt: **20.04.2026**

Në bazë të dispozitave të nenit 7 të Rregullores me nr 1/333 të datës 24.02.2026 për Procedurën e Dhënies me Qira të Hapësirave, dhe pas identifikimit nga Zyra për Marrëdhënie me Klient, Marketing dhe Promocion për hapësirat e lira sipas nenit 12, dhe bazuar në vendimin e datës **20.04.2026** Kryeshefi Ekzekutiv, **Shpend Bilalli** N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A., me seli në Prishtinë, me datën **20.04.2026**, mori këtë:

**FTESË PËR OFERTË**

N.P.L. Pallati i Rinisë SH.A. fton të gjitha subjektet e interesuara:

- Personat juridik (për ushtrim të veprimtarisë – afarizëm),
- Personat fizik dhe juridik (për depo),  
të aplikojnë për marrjen me qira të hapësirave për një periudhë të caktuar.  
Hapësirat e destinuar për persona juridik – hapësira afariste:

Nr.	Adresa	Sipërfaqja	Çmimi për m <sup>2</sup>
1.	Lok. Nr. 086 / <b>QT51</b> (ish Charlie)	233.14 m <sup>2</sup>	24.65€ Neto
2.	Lok. Nr. 32,33 / <b>QT16</b> (ish ANNOA)	34.71 m <sup>2</sup>	18.92€ Neto
3	Lok. Nr. 31 / <b>QT9</b> (Rialko lirohet me 01.05.2026)	92.06 m <sup>2</sup>	18.92€ Neto
4.	Lok. Nr. 41 / <b>QT22</b> (Moda Men lirohet me 01.05.2026)	254.59 m <sup>2</sup>	18.92€ Neto
5.	Zyrja Nr 116/2 / <b>SU097-1</b> përballë sallës së vogël (DIGJIT – ALB)	34.71 m <sup>2</sup>	5.99€ Neto
6.	Zyre Nr 05,06,07,09 / <b>PR59</b> (Game Plus lirohen 16.05.2026) perballe Rilinjës rr.kryesore	134.79 m <sup>2</sup>	10.89€ Neto
7.	<b>Zyre nr. 06 / SU006</b> (Që ndodhet në pjesën A (Llamella A) në nivelin përdhes në pjesën jugore të sallës universal)	12.28m <sup>2</sup>	10.89 € Neto
8.	<b>Zyre nr. 07 / SU007</b> (Që ndodhet në pjesën A (Llamella A) në nivelin përdhes në pjesën jugore të sallës universal)	12.18 m <sup>2</sup>	10.89 € Neto
9.	<b>Zyre nr. 08 / SU008</b> (Që ndodhet në pjesën A (Llamella A) në nivelin përdhes në pjesën jugore të sallës universal)	11.96 m <sup>2</sup>	10.89 € Neto
	<b>DEPOT E SPORTIT</b>		
10.	Depo nr. <b>SU081</b> (përball trim kabinetit në korridorin e Sallës së Vogël të SportitDEPO NEN SHKALL)	112.5 m <sup>2</sup>	3.58 € Neto
<b>11.</b>	Depo nr. <b>SU076</b> (ish Sigurimit në korridoret e Sallës së Vogël të Sportit)	27.58 m <sup>2</sup>	3.58 € Neto

### Vërejtje:

Për hapësirat sportive, mund të aplikojnë vetëm federatat dhe klubet sportive, pasi ato janë të destinuara për veprimtari sportive.

### Afati i kontratës:

Një (1) vit nga data e lidhjes së kontratës.

### Dokumentet që duhet të dorëzohen:

1. Formulari i aplikimit i cili mund të shkarkohet përmes ueb faqes/emailit zyrtar,
2. Kopje e certifikatës së regjistrimit të biznesit dhe numrit fiskal me të dhëna përkatëse;
3. Kopje e dokumentit të identifikimit të përfaqësuesit ligjor të biznesit;
4. Oferta financiare – çmimi për m<sup>2</sup> (pa TVSH);
5. Vërtetim nga ATK-ja që dëshmon se biznesi është aktiv;
6. Të dhënat e arkës fiskale;
7. Dëshminë e pageses për aplikim në vlerë prej 300 euro e cila paguhet në xhirollogaritë e Pallatit,

### Kriteret për përzgjedhjen e ofertuesit më të favorshëm:

1. Çmimi më i lartë se sa çmimi fillestar i shpallur për m<sup>2</sup>;
2. Tarifa e aplikimit është 300,00 €, e cila paguhet në xhirollogari;
3. **17-08-0206-000-000-56 (NLB)**
4. **20-33-0002-180-440-76 (TEB)**
5. **2415-1306-0000-2579 (PriBank)**

Tarifa kompensohet me faturën e parë të qirasë.

- Nëse ofertuesi i përzgjedhur tërhiqet nga kontrata, tarifa nuk i kthehet.
- Ofertuesve të pazgjedhur, tarifa u kthehet.

### Ofertat nuk do të merren parasysh në rastet kur:

1. Ofertuesi ka qenë qiramarrës i papërgjegjshëm më parë;
2. Oferta nuk përmban të gjitha dokumentet e kërkuara;
3. Oferta arrin pas datës dhe orës së përcaktuar.

### Afati i dorëzimit të ofertave:

Ofertat duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur më datë **29.04.2026, deri në ora 13:30** në Zyrën e Arkivës – N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.

Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të shënohet:

- Emri i ofertuesit
- Numri i hapësirës
- E-maili zyrtar
- Numri i telefonit

### Hapja e ofertave:

Ofertat do të hapen nga Komisioni për Vlerësim në prani të ofertuesve,

10 minuta pas përfundimit të afatit të dorëzimit – pra më **29.04.2026, deri në ora 13:40,** në zyrë e Drejtorisë së N.P.L. Pallati i Rinisë SH.A.

### Vizitat në hapësira:

Të gjithë të interesuarit mund t'i vizitojnë hapësirat nga **20.04.2026 deri më 29.04.2026 në ora 11:30,**

çdo ditë pune, nga ora 10:00 – 15:00,

duke u lajmëruar te Recepcioni i N.P.L. Pallati i Rinisë SH.A.

### Kërkesa / Aplikacioni mund të merret:

- Në e-mail: [contact@pallatirinise.com](mailto:contact@pallatirinise.com)
- Në uebfaqen zyrtare: [www.pallatirinise.com](http://www.pallatirinise.com)
- Fizikisht në Recepcionin e N.P.L. Pallati i Rinisë SH.A.

Për më shumë informata, jeni të mirëpritur të kontaktoni me zyrën përkatëse.